



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**



V E N D I M

Nr. 34, date 20.05.2019

PËR DISA SHTESA NË VKB NR. 6, DATË 30.1.2018 "PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË FUNKSIONARËVE TË ZGJEDHUR OSE TË EMËRUAR, TË NËPUNËSVE CIVILË E TË PUNONJËSVE ADMINISTRATIVË TË BASHKISË SHKODËR DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË", TË NDRYSHUAR

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 20.5.2019, në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1.1, shkronja "b", të nenit 51 pika 1, të nenit 54 shkronja "ç", të nenit 55 pika 2, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; ligjit nr.10405, date 24.3.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve"; ligjit nr. 79/2017 "Për sportin", VKM nr. 165, datë 2.3.2016, "Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar; VKM nr. 809, datë 26.12.2018 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", VKM nr. 354, datë 29.8.1994 "Për shpërblimin e cilësisë së veprimtarisë sportive", i ndryshuar, VKM nr. 687, datë 14.11.2018 "Për kriteret, mënyrën e shpërblimit dhe përfitimin e trajtimit për përgatitjen sportive të sportistëve që përfitojnë statusin e nivelit të lartë", VKM nr. 555, datë 11.8.2011 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me asrim të lartë në sistemin e ministrisë së shëndetësisë dhe spitalit ushtarak qendror universitar, në sistemin e ministrisë së mbrojtjes si dhe për trajtimin e mjekëve në strukturat e forcave të armatosura" të ndryshuar, VKB Nr.82, datë 20.12.2018 "Për miratimin e Buxhetit për vitin 2019 dhe programit buxhetor afatmesem perfundimtar 2019-2021 të Bashkisë së Shkodrës" me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

V E N D O S I :

1. Miratimin e shtesës në nivelin e pagave të punonjësve të shërbimit të institucioneve të varësisë sipas tabelës nr. 2 bashkëngjitur.
2. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë më hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miraturar në datën 20.5.2019

Shpallur në datën 21.5.2019

Sekretar i këshillit



Suel Hadri

KRYETAR



Xhemal BUSHATI

Niveli i pagave të punonjësve të shërbimit

- VKM nr. 354, datë 29.8.1994 “Për shpërblimin e cilësisë së veprimtarisë sportive për sportistët, trajneret dhe gjyqtarët dhe shpërblimet e tjera për veprimtaritë sportive”, i ndryshuar.
- VKM nr. 687, datë 14.11.2018 “Për kriteret, mënyrën e shpërblimit dhe përfitimin e trajtimit për përgatitjen sportive të sportistëve që përfitojnë statusin e nivelit të lartë”, pika 4 e kreut III, ku përcaktohet : “trajnerët e kontraktuar me kohë të pjesshme pranë klubeve sportive/shumësportesh do të paguhen në masën 500 (pesëqind) lekë për orë stërvitore dhe jo më shumë se 1 000 (një mijë) lekë në ditë për 25 (njëzet e pesë) ditë në muaj”.
- VKM nr. 555, datë 11.8.2011 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin e ministrisë së shëndetësisë dhe spitalin ushtarak qendror universitar në sistemin e ministrisë së mbrojtjes, të punonjësve të infermieristikës në sistemin e ministrisë së shëndetësisë e ministrisë së mbrojtjes si dhe për trajtimin e mjekëve në strukturat e forcave të armatosura”, të ndryshuar

Shtohet

Emertimi	Vendndodhja	I/E zgjedhur, emeruar	Arsimi i larte		Arsim i mesëm		Vjetërsia
			Kategoria	Pozicioni	Klasa	Paga bazë mujore	Shtesa për vjetërsi në përqindje
Trajner i sportistëve jo efektivë	Institucion varësie					200 lekë/orë	
Trajner i sportistëve të nivelit të lartë	Institucion varësie					500 lekë/orë	
Mjek	Institucion varësie		I	46,000			2%

Sekretar i këshillit



Suel Hadri

KRYETAR



Xhemal BUSHATI